Crna Gora - Mali i Ž.
JZU Dom zdravlja "Bogdan Vujošević
IPSH Shtepia e shendetit "Bogdan Vujoshevic"
Broj/nr. 1053
Ulcinj-Ulqin: 18.06.2025

DOM ZDRAVLJA-BOGDAN VUJOŠEVIĆ-ULCINJ
SHTËPIA E SHËNDETIT BOGDAN VUJOŠEVIĆ
ULQIN

Duke pasur parasysh që 26 qershori është Dita Ndërkombëtare për Luftën kundër Përdorimit të Drogave, Ministria e Shëndetësisë ka nisur një iniciativë që në Shtëpitë e Shëndetit të organizohet Java e Dyerve të Hapura me titull: "Thyerja e zinxhirëve: Parandalimi, trajtimi dhe rikuperimi për të gjithë."

Ju njoftojmë se në institucionin tonë shëndetësor SHSH ULQIN, në periudhën prej 23-27.6.2025, do të mbahet Java e Dyerve të Hapura me titull: "Thyerja e zinxhirëve: Parandalimi, trajtimi dhe rikuperimi për të gjithë." Kjo iniciativë është menduar për të promovuar shëndetin mendor, për të ofruar mbështetje për personat që përdorin drogë dhe për të theksuar rëndësinë e parandalimit të përdorimit të drogës.

Shtëpia e Shëndetit do të jetë e hapur nga ora **07:00** deri në **21:00** për të gjithë personat që përdorin drogë, prindërit/kujdestarët, të afërmit, miqtë të cilët kanë shqetësime dhe paqartësi në lidhje me të dashurit e tyre.

Gjatë këtij aktiviteti pesëditor, do të keni mundësinë të njiheni me ekipin tonë profesional i cili do të jetë në dispozicion për biseda individuale, konsultime dhe përgjigje për të gjitha pyetjet që keni në lidhje me shëndetin mendor dhe përdorimin e drogës.

Këshillimi është falas, anonim dhe vullnetar.

Qëllimi i kësaj iniciative është ngritja e vetëdijes për pasojat e dëmshme të drogës, theksi është në parandalim dhe forcimin e vetëdijes dhe personalitetit – "e jotja „JO" do të thotë gjithçka".

Ju kujtojmë që ky aktivitet është i hapur për të gjithë personat e interesuar, pavarësisht nga mosha apo përvoja e mëparshme me përdorimin e drogës. Pavarësisht nëse dëshironi vetëm të informoheni, të bëni një pyetje apo të flisni për sfidat tuaja personale, ekipi ynë do të jetë aty për t'ju ofruar mbështetje dhe këshilla profesionale.

Ju presim!

SHTËPIA E SHËNDETIT ULQIN

Direktor

Dr Kreshnik Mustafa spec. epidemiologije